



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBRUESVE GJYQËSORË PRIVAT  
ZYRA PËRMBARIMIT PRIVAT "ALBASE"SH.P.K.

Adresa : Rr." Reshit Çollaku " pallati 24, kati i II

Tel. 0674005151

Nr.1160/D

Tiranë,më dt.01.12.2023

Nr. 1160/II Prot.

Lënda : Urdhër për Heqjen e sekuestros konservative mbi Kuotat.

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit .

Debitorit : Shoqëria "DONI FRUITS"shpk me NIPT L34502401K administrator Burim Ahmeti.

Adresa : Fier-Lushnje,Karburnar e Poshtme,rruga Lushnje-Berat 1km,nr.pasurie 839/29,zk.2087.

Për dijeni : Kreditori Shoqëria "LLAZO"shpk me NIPT K24218401K, administrator Aldi Llazi.

Adresa : Fier-Lushnje,Bishqethëm,rruga Këmishtaj nr.pasurie 3/21,zk.2087.

Qendra Kombëtare e Biznesit,Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm  
Berat,Bashkia Lushnje.

Tiranë.

Në Tiranë sot me dt.01.12.2023.

Unë Baftjar Abdulla Nela Përmbaues Gjyqësor Privat pranë Zyrës Përmbaimit Privat "ALBASE" shpk me çertifikatë Nr.66,dt.22.07.2011 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, me NIPT L12009010A, bazuar në vendimin civil i formës së prerë "Urdhëri i Ekzekutimit" në origjinal Nr.222(1881), dt.12.07.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

### K O N S T A T O V A :

Se në dt.25.09.2023 është depozituar kërkesa e kreditorit për ekzekutim pranë Zyrës Përmbaimit Privat "ALBASE"shpk Tiranë së bashku me vendimi civil i formës së prerë "Urdhëri i Ekzekutimit" në origjinal Nr.222(1881),dt.12.07.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, lëshuar për titullin ekzekutiv Fatur Tatimore Shitje nr.947/2022,dt.08.12.2022, me palë:

-Kreditor : Shoqëria "LLAZO"shpk me NIPT K24218401K, administrator Aldi Llazi.

-Debitor : Shoqëria "DONI FRUITS"shpk me NIPT L34502401K administrator Burim Ahmeti.

-Me objekt : Pranimin e kërkesë së kërkuarit Shoqëria "LLAZO"shpk

Lëshimin e urdhëri të ekzekutimit për Faturën Tatimore të Shitjes nr.947/2022, dt.08.12.2022 lëshuar ndaj debitorit Shoqëria "DONI FRUITS"shpk me NUIS L345024-01K në shumën18.684.480(tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë) lek si dhe kamat vonesat ligjore pas datës 21.06.2023 e deri në ekzekutimin e detyrimit , duke u llogaritur sipas ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare",i ndryshuar.

Ngarkohet Shërbimi Përmbaimit gjyqësorë,shtetëror ose private, për zbatimin e këtij urdhëri ekzekutimi.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje dhe si i tillë ka vlerë.  
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

Në kushtet kur ekzekutimi i vendimit civil i formës së prerë "Urdhëri i Ekzekutimit" në original Nr.222 (1881),dt.12.07.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, lëshuar për titullin ekzekutiv Fatur Tatimore Shitje nr.947/2022,dt.08.12.2022, nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga debitori dhe për këtë arsye duhet të kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe për vazhdimin e tij duhet të kryhet:

*-Urdhër për Heqjen e sekuestros konservative mbi Kuotat e debitorit Shoqëria "DONI FRUITS" shpk me NIPT L34502401K administrator Burim Ahmeti,pasi palët kanë bërë marrëveshje për të paguar detyrimin.*

Sa më sipër në mbështetje të neneve 519,526/a,527,528,531,586,616/A të Kodit të Proçedurës Civile dhe Ligjit Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat."

### U R D H Ë R O J M Ë :

1- Qëndrën Kombëtare e Biznesit të vendosi Heqjen sekuestros konservative mbi Kuotat e debitorit Shoqëria "DONI FRUITS" shpk me NIPT L34502401K administrator Burim Ahmeti,pasi palët kanë bërë marrëveshje për të paguar detyrimin.

2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3-Personat që bëhen pengesë do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të Kodit të Proçedurës Civile që parashikon vendosjen e gjobës dhe kallëzim penal.

4-Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

ZYRA PËRMBARIMIT PRIVAT "ALBASE" SH.P.K.  
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT  
BAFTIAR NELA

